



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



# **Raport përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale të FSHU-së**

## **Përgjigje ndaj Komenteve**

**(Viti relevant tarifor 2021)**

**Tetor 2021**

## **Përmbajtja**

<b>1</b>	<b>Përmbledhje .....</b>	<b>3</b>
<b>2</b>	<b>Komentet e KESCO-së për shitblerjet e energjisë elektrike .....</b>	<b>5</b>
	Përgjigjet e ZRRE-së .....	5
<b>3</b>	<b>Komentet e KESCO-së lidhur me shpenzimet operative .....</b>	<b>6</b>
	Përgjigjet e ZRRE-së .....	8
<b>4</b>	<b>Kostot e bartshme.....</b>	<b>9</b>
	Përgjigjja e ZRRE-së .....	10
<b>5</b>	<b>Të hyrat aktuale të rregulluara dhe korigjimi i të hyrave .....</b>	<b>10</b>
	Përgjigjet e ZRRE-së .....	10
<b>6</b>	<b>Borxhi i keq.....</b>	<b>11</b>
	<i>Përgjigjet e ZRRE-së .....</i>	<i>11</i>
<b>7</b>	<b>Të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU për vitin relevant tarifor 2021.....</b>	<b>12</b>



## 1 Përmbledhje

Ky dokument paraqet përgjigjet në komentet e dhëna nga palët e interesuara dhe propozimin përfundimtar të ZRRE-së lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale të FSHU-së për vitin relevant tarifor 2021.

Pas vlerësimit fillestar të aplikacioneve lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale për të licencuarin e Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU, KESCO), i licencuari dhe palët tjera të interesit kanë pasur mundësi ti paraqesin komentet e tyre përmes konsultimit publik për periudhë dy javore.

Procesi i shqyrtimit për vitin relevant tarifor 2021, është dashur të përmbillet me vendime nga ana e Bordit të ZRRE-së deri në fund të muajit marsit 2021, mirëpo kjo nuk ka ndodhur duke qenë se Bordi nuk ishte funksional deri më 2 gusht 2021, kur edhe është plotësuar me zgjedhjen e dy anëtarëve dhe kryesuesit nga ana e Parlamentit të Republikës së Kosovës. Menjëherë pas plotësimit të bordit, ZRRE ka vazhduar me procesin e shqyrtimit tarifor. ZRRE kishte përgatitur raportin konsultativ në muajin mars të vitit 2021, i cili është vendosur në konsultim publik më 24 gusht 2021. Raporti konsultativ përmbante vlerësimin fillestar të ZRRE-së ndaj aplikacioneve të të licencuarve për kërkesën e të hyrave për vitin relevant tarifor 2021. Të gjitha kalkulimet bazoheshin në të dhënat në dispozicion të vitit 2020 dhe parashikimet për vitin 2021.

Gjatë konsultimit publik, ZRRE ka pranuar komente dhe informata të rëndësishme shtesë, të cilat janë marrë në konsideratë në vlerësimin përfundimtar të propozimit për të hyrat e të licencuarve. Ndryshimet kryesore kanë të bëjnë me ngritjen e çmimeve të energjisë me shumicë si dhe në rritjen e konsumit të energjisë elektrike. Kjo është ndikuar kryesisht nga tregjet/bursat ndërkombëtare të energjisë dhe aplikimit të taksave të karbonit në vendet e EU-së. Duke qenë se këta faktorë kanë ndikuar në kostot e OSSH-së, dhe të cilat ishin jashtë kontrollit të saj, ZRRE në vlerësimin përfundimtar ka marrë parasysh këto rrethana dhe ka rivlerësuar kostot e blerjes së energjisë me shumicë, si dhe ka reflektuar edhe ndryshimet në konsumin e energjisë elektrike. Të gjitha këto ndryshime në tregjet e energjisë me shumicë dhe pakicë janë pasqyruar në MAR përfundimtar të FSHU-së për vitin relevant tarifor 2021.



#### Dokumentet relevante:

Aplikimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale në vitin 2021 për Furnizuesin me Shërbim Universal	<a href="https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Konsultimet%20Publike/Aplikimi%20i%20FU%20SH-s%C3%AB%202021%20-%208%20Mars%202021.pdf">https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Konsultimet%20Publike/Aplikimi%20i%20FU%20SH-s%C3%AB%202021%20-%208%20Mars%202021.pdf</a>
Aplikimi i KOSTT për Azhurnimet vjetore për tarifat e KOSTT që pritet të hyjnë në fuqi më 1 prill 2021	<a href="https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Konsultimet%20Publike/Aplikacioni_%20p%C3%ABrshtetjet%20vjetore%202021_%20KOSTT.pdf">https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Konsultimet%20Publike/Aplikacioni_%20p%C3%ABrshtetjet%20vjetore%202021_%20KOSTT.pdf</a>
Aplikimi i KEDS për të Hyrat e Lejuara Maksimale në vitin 2021	<a href="https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Konsultimet%20Publike/Aplikimi%20i%20OS%20SH-s%C3%AB%202021%20-%208%20Mars%202021.pdf">https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Konsultimet%20Publike/Aplikimi%20i%20OS%20SH-s%C3%AB%202021%20-%208%20Mars%202021.pdf</a>
Raport konsultativ për MAR-in e FSHU	<a href="https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Komunikatat/FSHU_Raport_Konsultativ%20per%20MAR_2021_24.08.2021.docx">https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Komunikatat/FSHU_Raport_Konsultativ%20per%20MAR_2021_24.08.2021.docx</a>
Raport konsultativ për MAR-in e KOSTT	<a href="https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Komunikatat/KOSTT_Raport_Konsultativ%20per%20MAR_2021_24.08.2021.docx">https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Komunikatat/KOSTT_Raport_Konsultativ%20per%20MAR_2021_24.08.2021.docx</a>
Raport konsultativ për MAR-in e KEDS	<a href="https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Komunikatat/OSSH_Raport_Konsultativ%20per%20MAR_2021_24.08.2021.docx">https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Komunikatat/OSSH_Raport_Konsultativ%20per%20MAR_2021_24.08.2021.docx</a>
Komentet e FSHU-së	<a href="https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/OT/Komentet%20e%20FSHU%20-%202021.pdf">https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/OT/Komentet%20e%20FSHU%20-%202021.pdf</a>
Komentet e KOSTT	<a href="https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/OT/210908_KOSTT_Komente%20lidhur%20me%20Raportin%20Konsultativ%20p%C3%ABr%20P%C3%ABrshtatjet%20vjet.....pdf">https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/OT/210908_KOSTT_Komente%20lidhur%20me%20Raportin%20Konsultativ%20p%C3%ABr%20P%C3%ABrshtatjet%20vjet.....pdf</a>
Komentet e KEDS	<a href="https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/OT/Komentet%20e%20OSSH-2021.pdf">https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/OT/Komentet%20e%20OSSH-2021.pdf</a>



## 2 Komentet e KESCO-së për shitblerjet e energjisë elektrike

KESCO në komentet e dërguara ndaj raportit konsultativ për të hyrat maksimale të lejuara për vitin relevant tarifar 2021, ka paraqitur propozim që ZRRE për periudhën janar-korrik ta konsideroj konsumin e realizuar të energjisë elektrike, bazuar në faktin që konsumi ka shënuar rritje prej rreth 11% krahasuar me konsumin e parashikuar në bilancin e energjisë elektrike. Si rrjedhojë edhe importi i energjisë elektrike gjatë periudhës 7 mujore të vitit 2021 është rritur dhe po ashtu edhe kërkesa për import është rreth 100% më e lartë në raport me planifikimin. Duke pasur parasysh që gjatë vitit 2021 tregjet ndërkombëtare të energjisë janë manifestuar me çmime të larta të energjisë elektrike, kjo ka ndikuar që edhe kostot e blerjes së energjisë elektrike për FSHU të rriten në raport me ato të planifikuara. Në bazë të informatave të paraqitura nga FSHU, të dhënat aktuale tregojnë se për muajt janar-korrik blerjet nga importi kanë arritur në 8 milion €, me një çmimin mesatar të realizuar prej 77.23 €/MWh, derisa gjithsej blerjet nga importi në raportin konsultativ parashiheshin në vlerë prej 5.6 milion €, sipas vlerave të parashikuara gjatë vitit 2020.

KESCO, në lidhje me çmimin e blerjes së energjisë nga KEK Sh.A thekson se gjatë llogaritjes së blerjeve me shumicë për Furnizuesin me Shërbim Universal, ZRRE-ja ka përdorur çmimin aktual për blerjet e KEK-ut dhe nuk ka reflektuar përshtatjen për normën e inflacionit siç kishte aplikuar Furnizuesi pas diskutimeve bilaterale me KEK gjenerimin. Të njëjtin çmim e ka përdorur edhe FSHU gjatë kalkulimit të blerjeve nga KEK-Gjenerimi.

Në lidhje me shitjen e energjisë elektrike nga HC Ujmani, KESCO pretendon që HC Ujmani ka shfrytëzuar pjesërisht dhe në afat të limituar shpalljen e ofertës dhe në këtë kuptim nuk është bërë njoftimi i duhur paraprak për shpalljen e tenderit. Në këtë mënyrë FSHU-së i është pamundësuar paraqitja e ofertës respektivisht blerja e energjisë elektrike nga HC Ujmani për këtë vit tarifar.

Marrë parasysh se FSHU-ja në aplikimin e saj ka përdorur vlerat aktuale për muajt janar-korrik, është e rëndësishme të theksohet se gjatë muajve janar-mars të hyrat e FSHU-së kanë qenë më të ulëta konform Marrëveshjes dhe Amendamentit të parë të Marrëveshjes për Implementimin e Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID-19 për subvencionimin e tarifës për Burimet e Energjisë së Ripërtëritshme. Njëherazi, FSHU ka qenë e liruar për obligimet ndaj KOSTT lidhur me BRE-të konform marrëveshjes së lartpërmendur.

### **Përgjigjet e ZRRE-së**

Lidhur me blerjet e energjisë për mbulimin e konsumit për konsumatorët me të drejt të Shërbimit Universal nga FSHU, duhet theksuar se ZRRE në vlerësimin fillestar kishte marrë për bazë trendin e çmimeve historike të importit, si dhe aplikacionin e KESCO të datës 8 mars 2021. Megjithatë, duke qenë se procesi tarifar nuk është përmbyllur si rezultat i mungesës së Bordit të ZRRE, tani kemi të dhëna të reja të cilat paraqesin gjendjen faktike të tregut të energjisë me shumicë. Si rezultat i ndryshimit të kushteve në tregjet ndërkombëtare të energjisë, edhe operatorët e sektorit të energjisë në Kosovë janë ndikuar nga çmime të larta. Përveç ndryshimit në çmime, sektori i energjisë në Kosovë gjatë periudhës janar-korrik 2021 ka pësuar edhe një rritje të konsumit të energjisë elektrike në raport me planifikimin e bilancit të energjisë elektrike.



ZRRE bazuar në kornizën ligjore në fuqi dhe pas vlerësimit të gjendjes aktuale, i njeh kostot shtesë për blerjen e energjisë elektrike ashtu siç janë të realizuara për periudhën janar-korrik 2021, të paraqitura nga KESCO. Për pjesën e mbetur të vitit 2021, ZRRE pas vlerësimit të trendit të çmimeve në bursat kredibile të energjisë si dhe studimet relevante lidhur me parashikimet e çmimeve të energjisë, ka rishikuar kostot e blerjes së energjisë edhe për periudhën e mbetur të vitit 2021. Çmimet e larta të energjisë me shumicë parashihen të jenë edhe në vitin 2022, sipas S&P Global parashikimi i çmimeve të energjisë në Evropë për vitin 2022 parashihet të jetë në brezin 80-90€/MWh<sup>1</sup>. Për periudhën e mbetur të vitit 2021, ZRRE ka aplikuar çmimin prej 90€/MWh për parashikimin e blerje të energjisë nga importi. Kjo bëhet me qëllim që të reflektojme koston reale të furnizimit me energji elektrike dhe që mos të bartim kosto të larta për vitin vijues, e cila do të mund të shkaktonte luhatje të mëdha të tarifave të energjisë elektrike për konsumatorët fundorë dhe do të rrezikonte likuiditetin e sektorit të energjisë në përgjithësi.

ZRRE sqaron për FSHU dhe për publikun, që çmimi i gjenerimit nga KEK Sh.A. nuk është subjekt i rregullimit dhe çmimi i përdorur për kalkulimet e koston së blerjes së energjisë nga KEK Sh.A është përdorur i njëjti çmim i paraqitur në Shtojcë të marrëveshjes për shit-blerje të energjisë mes KEK dhe KESCO.

Në lidhje me arsyeshmërinë e ofruar nga KESCO për pamundësinë e blerjes së energjisë nga HC Ujmani, ZRRE thekson që KESCO ka obligim që të kujdeset për plotësimin e kërkesës për energji elektrike të konsumatorëve FSHU me çmime të arsyeshme, transparente, konkurruese dhe efikase, andaj është në përgjegjësinë menaxheriale të KESCO që konsumatorët FSHU të furnizohen me kushtet më të favorshme që mund të gjinden në treg.

KESCO ka përshkruar në komentet e dërguara, se Qeveria e Republikës së Kosovës kishte ndarë një fond për subvencionimin e konsumatorëve për energjinë e blerë nga Burimet e Ripërtëritshme, si pjesë e Implementimit të Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID-19. Kjo kishte ndikuar në uljen e faturave të energjisë elektrike për konsumatorët fundorë, ndërsa nuk kishte ndikim në kostot e FSHU-së.

### 3 Komentet e KESCO-së lidhur me shpenzimet operative

**Shpenzimet për konsumatorët e rregulluar** - Furnizuesi i Shërbimit Universal sqaron se gjatë aplikimit për të hyrat e lejuara maksimale ka përdorur shpenzimet operative sipas aplikimit për parametrat rregullativ, dorëzuar në ZRRE më 8 tetor 2020, për të cilat ende nuk ka pranuar një vlerësim. Ky raport ka paraqitur në formë të detajuar kërkesën për shpenzimet operative, ashtu siç kërkohet nga ZRRE-ja në shkresën nr. 295/20 të dt.19.09.2020 mbi Shqyrtimin e Parametrave hyrës dhe të hyrave të lejuara për FSHU-në. Në të njëjtën aplikim, FSHU ka theksuar se kërkesa e paraqitur në këtë dokument nuk i përfshin kostot operative për furnizimin e konsumatorëve të parregulluar, të cilët pritej të furnizoheshin me tarifa të parregulluara nga 1 prilli i vitit 2021. Për më tepër, edhe në pasqyrat financiare dhe rregullative Furnizuesi ka paraqitur ndaras kostot për shpenzimet operative për konsumatorët që furnizohen me tarifa të rregulluara dhe atyre të parregulluara. Kërkesa e ZRRE-së

<sup>1</sup> [www.spglobal.com](http://www.spglobal.com); [European power forecast to hold near record levels to 2023: Platts Analytics | S&P Global Platts \(spglobal.com\)](https://www.platts.com); e vizituar me 28 shtator 2021, ora 16:03



për të paraqitur kostot që ndërlidhen me ofrimin e shërbimeve për konsumatorët e parregulluar mbetet e paqartë andaj kërkojmë me mirësjellje nga ZRRE-ja të shpjegoj kërkesën e tyre me qëllim që Furnizuesi të ofroj informatat e kërkuara nga ZRRE-ja sipas kërkesës së tyre.

**Kostot shtesë lidhur me pandeminë COVID 19** - Në vlerësimin e kostove operative për vitin 2021, kemi vërejtur se ZRRE ka pasqyruar rritjen e kostove për sigurimin shëndetësor, por nuk i ka marrë në konsideratë komentet e FSHU-së lidhur me zbritjen e njëanshme të kostove për shpenzimet operative gjatë vitit 2020, sikurse nuk i ka marrë parasysh shpenzimet jashtë kontrollit të FSHU lidhur me përhapjen e pandemisë COVID-19, kërkesat për shpenzime shtesë lidhur me hapjen e tregut, apo kërkesat e punëtorëve për nivelim të pagave me sektorët e tjerë. Tutje, FSHU argumenton se përderisa pothuajse të gjitha bizneset tregtare qëndruan të mbyllura dhe shumica e të punësuarve u liruan kohë pas kohe nga përgjegjësitë në punë, punonjësit e furnizuesit vazhdimisht kanë punuar në përmbushjen e detyrave të tyre për të siguruar furnizim të rregullt me energji elektrike për çdo qytetar në Kosovë, duke rrezikuar kështu shëndetin e tyre.

FSHU kërkesën e saj për të stimuluar punonjësit që ishin duke punuar në kushte pandemie e bazon se në mars të vitit 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës mori një vendim për të stimuluar punonjësit që ishin duke punuar me përkushtim për të tejkaluar këtë periudhë të jashtëzakonshme me shumë rreziqe. Furnizuesi parashtrroi kërkesë të ngjashme në ZRRE, që kostot shtesë të shkaktuara nga përhapja e pandemisë COVID-19, por edhe një pagesë shtesë të njihet në shqyrtimin e ardhshëm tarifor dhe kërkon nga ZRRE t'i reflektoj këto kosto.

**Kostot për shërbimet e përbashkëta** - Sa i përket këtyre kostove, FSHU në komentet e dhëna thekson se ZRRE-ja i ka zbritur njëanshëm pas publikimit të raportit konsultativ, gjithashtu FSHU pretendon se shpenzimet operative për Furnizuesin me Shërbim Universal aprovohen në total dhe ato nuk përputhen me kërkesat vjetore të Furnizuesit gjatë viteve, pasi kostot e lejuara janë vazhdim i parashikimeve të bëra gjatë periudhës së parë rregullative dhe nuk paraqesin pasqyrim të ndryshimit të çmimeve gjatë viteve.

Lidhur me shpenzimet operative FSHU kërkon që gjatë përcaktimit të tyre të merren parasysh kostot aktuale dhe të justifikueshme përpara se të bëhen përshtatje që ndikojnë me mbi 25% të total kostove operative, dhe se ulja e tyre e ka vendosur Furnizuesin e Shërbimit Universal në një pozicion shumë të pafavorshëm financiar. Po ashtu, FSHU thekson se ka mbyllur vitin 2019 me humbje dhe në të njëjtën kohë gjatë vitit 2020 u përball me probleme të arkëtimit, si rezultat i përhapjes së pandemisë globale COVID-19, gjë që ndikoi më tej në kapacitetet e saj të pagesave për të mbuluar detyrimet e saj ndaj operatorëve të tjerë, duke rezultuar sërish me humbje. Në këtë kuptim FSHU, kërkon nga ZRRE që të marrë në konsideratë shpenzimet operative sipas kërkesës së saj të përshtatur me shpenzimet e realizuara gjatë vitit 2020.

**Shpenzimet nga të drejtat e përdorimit** - Në komentet e saja lidhur me shpenzimet operative, FSHU thekson se të dhënat e paraqitura në pasqyrat financiare në lidhje me kostot operative ndryshojnë nga ato të lejuara nga ZRRE-ja, siç janë shpenzimet e qirasë të cilat nga viti 2019 (përfshirë edhe vitin 2020) në përputhje me parimet e kontabilitetit (IFRS 16) kërkojnë trajtimin e shpenzimeve të qirasë operative si qira financiare dhe të njëjtat në Bilancin e gjendjes paraqiten në kuadër të zërit 'Të drejtat e përdorimit të pasurive dhe detyrimet për qiratë'. Përkatësisht shpenzimet e qirasë si pjesë e shërbimeve të përbashkëta të cilat furnizuesi ia paguan OSSH-së, nuk janë marrë parasysh nga ZRRE-



ja gjatë zbritjes së këtyre kostove dhe në këtë kuptim konform marrëveshjes ndërmjet palëve kërkojmë që e njëjta të përshtatet gjatë shqyrtimit të kërkesës së furnizuesit.

### **Përgjigjet e ZRRE-së**

**Shpenzimet për konsumatorët e rregulluar** - Lidhur me ndarjen e kostove për shërbimin e konsumatorëve të rregulluar dhe atyre të parregulluar, ZRRE ka kërkuar informatat e tilla në pajtim me pritjet e saja për të përcaktuar parametrat hyrës për FSHU-në dhe shpenzimet e operative për periudhë trevjeçare sipas rregullës për të hyrat e FSHU-së. Duke qenë se ZRRE ka pasur mungesë të bordit nga muaji dhjetor i vitit 2020, procesi i tillë i vendosjes së parametrave hyrës dhe shpenzimeve operative për FSHU-në nuk ka mundur të përmbyllet në vitin 2021.

Duke marrë parasysh rrethanat aktuale në tregun e energjisë në Kosovë, si dhe rrethanat me pandeminë, ZRRE vendosi të shtyjë procesin e hapjes së tregut për konsumatorët e kyçur në nivelin e tensionit 35kV dhe 10kV. Lidhur me paqartësitë e FSHU-së për kërkesën e ZRRE-së për ndarjen e Shpenzimeve Operative (OPEX) në mes të konsumatorëve të rregulluar dhe atyre të parregulluar, qëllimi i kërkesës ishte që të ketë një ndarje të tillë të paktën për konsumatorët të cilët aktualisht furnizohen me çmime të parregulluara (konsumatorët e kyçur në nivelin e tensionit 220kV dhe 110kV). Në mungesë të këtyre të dhënave si dhe ndikimit të vogël që ka ndarja e këtyre kostove, ZRRE do të trajtojë kostot si të përbashkëta, mirëpo ato do të azhurnohen në shqyrtimin e ardhshëm periodik. Gjithsesi, ZRRE do të kujdeset që të monitoroj aspektin e aktiviteteve të rregulluara dhe atyre të parregulluara të furnizimit me energji elektrike.

**Kostot shtesë lidhur me pandeminë COVID 19** - ZRRE rithekson që sheh të arsyeshme në parim njohjen e kostove që ndërlidhen me ruajtjen e shëndetit si pasojë e COVID-19, sipas Udhëzimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike. Siç e ka paraqitur në shkresat në të cilat thirret FSHU, ZRRE propozon njohjen vetëm të kostove direkte që ndërlidhen me ruajtjen e shëndetit si pasojë e COVID-19.

Në lidhje me pretendimin e FSHU-së se operatorët tjerë në sektorin e energjisë kanë ofruar shtesa për punëtorët gjatë pandemisë, ZRRE sqaron për FSHU dhe për publikun, që FSHU do të mund të konsideronte një pagesë të tillë ndaj punëtorëve, vetëm përmes fitimit të ndërmarrjes, ashtu siç kanë vepruar edhe operatorët tjerë, të cilët këto kosto nuk i kanë reflektuar në çmimet e tyre.

Gjithashtu ZRRE shpreh shqetësim që FSHU edhe gjatë fazës së konsultimit publik të raporteve konsultative, nuk ka paraqitur kostot direkte që ndërlidhen me ruajtjen e shëndetit si pasojë e COVID-19, mirëpo atë e ka grumbulluar me kërkesën e tyre për shtesa ndaj punëtorëve. Përkundër kësaj, ZRRE ka kërkuar edhe njëherë, pas mbylljes së konsultimit publik, të dhëna detaje në lidhje me kostot direkte për pandeminë. Nga informatat e pranuar nga FSHU, rezulton që kosto shtesë për pandeminë janë rreth 6,398 Euro (shpenzime për maska, veshje, dezinfektues, produkte të tjera higjienike), ndërsa pjesa prej 36,351 Euro ishte në emër të shtesave për punëtorë.

ZRRE propozon që të njihen vetëm kostot direkte për menaxhimin e situatës me COVID-19, të mbështetura edhe me Udhëzimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, e të cilat janë përlogaritur në vlerën pre 6,398 Euro.





**Kostot për shërbimet e përbashkëta** - ZRRE gjatë përcaktimit të MAR-it lejon nivel të arsyeshëm të kostove pa cenuar likuiditetin financiar të kompanisë ngase këto kosto barten te konsumatorët përmes tarifave. Duke qenë se kostot për shërbime të përbashkëta janë kosto të bartshme për FSHU-në, si dhe janë jashtë kontrollit të FSHU-së, ZRRE ka vlerësuar se është e nevojshme të rishikohen kostot për shërbimet e përbashkëta për FSHU-në. Arsye për këtë rishikim të kostove të shërbimeve të përbashkëta në vitin 2020 kanë qenë dallimet e theksuara ndërmjet lejimeve dhe realizimeve. ZRRE dëshiron të theksojë se niveli i shpenzimeve operative në tërësi, duke përfshirë edhe kostot për shërbimet e përbashkëta, si pikë fillestare kishte marrë për bazë studimet dhe vlerësimet për nivelin e shpenzimeve operative të nevojshme për të kryer aktivitetin e furnizimit. Duhet theksuar se ky nivel i OPEX-it është azhurnuar për të marrë në konsideratë kërkesat për kosto shtesë të personelit dhe sigurimit shëndetësor në vitin 2018. Po ashtu këto kosto azhurnohen në baza vjetore për të marrë në konsideratë edhe normën e inflacionit. Prandaj, pretendimi i FSHU-së se këto kosto janë statike nuk qëndron bazuar në argumentet e dhëna më sipër.

Sa i përket pretendimeve lidhur me problemet e arkëtimit të të hyrave nga KESCO, ZRRE përmes parametrave hyrës rregullativ lejon një nivel të arsyeshëm të borxhit të keq në koston reale të shërbimit të konsumatorëve të rregulluar tarifor. Marrë parasysh rrethanat me pandeminë, ZRRE inkurajon operatorin që të bëjë përpjekje për të ruajtur nivelin e borxhit të keq brenda nivelit të lejuar.

**Shpenzimet nga të drejtat e përdorimit** – ZRRE, përmes investimeve të lejuara përcakton Bazën e Rregulluar të Aseteve e cila përfshinë asetet që janë në përdorim dhe janë të dobishme për ofrimin e shërbimeve të konsumatorëve nga subjekti i rregulluar. Në këtë kuptim jetëgjatësia ekonomike e asetëve duhet të jetë në përputhje me jetëgjatësinë e asetëve të vendosur nga Rregullatori. Andaj, kërkesa për të njohur shpenzimet e zhvlerësimit dhe njohjen në RAB të komponentës së kostove të pretenduara nga e drejta e përdorimit, nuk është në harmoni me legjislacionin sekondar që trajton aspektet tarifore. Duke pasur parasysh se KESCO ka ndryshuar politiken e trajtimit të shpenzimeve të qirasë e cila është e ndërlidhur me KEDS, po ashtu ndryshimi i tillë është bërë pa njoftim paraprak me rregullatorin. ZRRE pas pranimit të komenteve nga ana e KESCO, ka mbajtur një takim për sqarime shtesë me stafin e KESCO. Nga ky takim është informuar që kostot e paraqitura nga të drejtat e përdorimit (zhvlerësimi), në fakt janë shpenzime të qirasë, vetëm se mënyra e trajtimit është bërë në përputhje me rregullat e reja të IFRS dhe jo sipas atyre rregullative. Anadaj ZRRE, duke marrë parasysh edhe sqarimet shtesë, propozon që çështja shpenzimeve të qirasë të trajtohet në periudhën e ardhshme rregullative.

#### **4 Kostot e bartshme**

FSHU ka vënë re që ZRRE-ja ka llogaritur më pak kosto për detyrimet e FSHU-së për përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes, por për të cilat nuk ka ofruar informata të detajuara. Marrë parasysh se të dhënat aktuale për muajt janar-korrik janë më të larta sesa vlerësimet e ZRRE-së, FSHU në raportin e vet ka paraqitur vlerat aktuale të realizuara për vitin 2021, ndërsa për muajt e mbetur duke mos ditur vlerësimet e sakta të ZRRE-së ka përdorur çmimet aktuale. FSHU kërkon nga ZRRE që më rastin e llogaritjes së çmimeve për operatorët e rrjetit të njëjtat duhet të reflektohet në kostot e FSHU-së.



## **Përgjigja e ZRRE-së**

Lidhur me parashikimin e kostove të bartshme për vitin 2021 (kostot e OST, OSSH, kostot e fondit për BRE), ZRRE në raportin konsultativ fillestar është bazuar në aplikacionet e muajit mars 2021 dhe rrethanat aktuale që kanë qenë në tregun e energjisë për vitin 2020. Lidhur me pretendimin se ZRRE nuk ka dhënë informata të detajuara në vlerësimin e këtyre kostove nuk qëndron, ngase raportet konsultative përfshijnë të gjitha detajet me të dhëna energjetike dhe financiare dhe ato kanë qenë publike. Për më tepër me FSHU janë ndarë edhe kalkulimet dhe modelet për të hyrat e lejuara maksimale. Është e thjeshtë për FSHU të vlerësojë se si kostot e OSSH-së janë bartur tek FSHU, ngase ato janë bartur 100%, duke konsideruar që të gjithë konsumatorët në nivel të OSSH furnizohen me tarifa të rregulluara. Sa i përket të dhënave për OST/OT, ZRRE konform vlerësimin fillestar të të hyrave të lejuara për OST/OT ka bërë parashikimin e kostove që i barten FSHU-së në harmoni me metodologjitë tarifore për OST/OT.

Bazuar në komentet, dëshmitë dhe rrethanat e ndodhura në tregun e energjisë me shumicë, siç janë përshkruar në kreun e dokumentit, që ka të bëjë me shitblerjet e energjisë, ZRRE në vlerësimin përfundimtar i ka reflektuar kostot që i barten FSHU-së në pajtimin me rishikimet e bëra të të hyrave të lejuara maksimale të operatorëve.

## **5 Të hyrat aktuale të rregulluara dhe korrigjimi i të hyrave**

Lidhur me korrigjimin e të hyrave, FSHU thekson se ZRRE-ja nuk ka marr parasysh shpenzimet e ndikuara nga përhapja e pandemisë COVID-19, ndërsa sa i përket obligimeve të furnizuesit ndaj Operatorit të Sistemit Transmetimit(OST), FSHU sqaron se vlera prej 15.22 milion € është në përputhje me pagesat që furnizuesi ia ka bërë OST-së në baza mujore. Marrë parasysh këto shpjegime dhe pretendimet e mësipërme të bëra nga FSHU, rezultojnë se vlera e përshtatjeve për vitin 2020 të jetë 5.51 milion €.

Lidhur me dallimet/jobalancet ndërmjet sasisë së energjisë së blerë me shumicë dhe sasisë së energjisë së faturuar tek konsumatorët fundor gjatë vitit 2020, FSHU thekson se nominimet ndërmjet palëve FSHU dhe OSSH realizohen në përputhje me udhëzimet, vendimet dhe procedurat rregullativës në fuqi. Për më tepër, të hyrat e realizuara nga FSHU-ja përmes mekanizmit balancues, Furnizuesi i kthen tek konsumatori fundor përmes përshtatjeve vjetore. FSHU gjithashtu thekson se për të reflektuar drejtë kostot, palët FSHU dhe OSSH aplikojnë korrigjimet e nevojshme mujore, sipas kalkulimeve të pranuar nga KOSTT.

## **Përgjigjet e ZRRE-së**

Sa i përket kostove që ndërlidhen me pandeminë COVID-19, siç është sqaruar më sipër, ZRRE propozon që të njihen vetëm kostot direkte për menaxhimin e situatës me COVID-19, të mbështetura edhe me Udhëzimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike.

Lidhur me kostot e bartshme për fondin e burimeve të ripërtëritshme të realizuara në vitin 2020, ZRRE në vlerësimin fillestar kishte njohur kostot në vlerë prej 14.9 milion Euro. Pas finalizimit të pasqyrave financiare për FSHU, kjo vlerë rezultojnë të jetë 15.2 milion Euro. ZRRE në vlerësimin përfundimtar ka pranuar këtë korrigjim, bazuar në të dhënat e audituara. Ndërsa, lidhur me kostot e bartshme të



operatorit të sistemit të shpërndarjes për vitin 2020, ZRRE vlerëson se obligimet e FSHU-së për OSSh-në duhet të mbesin të njëjta (prej 100.55 milion Euro), që nënkupton se edhe kostot që kanë të bëjnë me jobalancet e shkaktuara të FSHU-së (në vlerë prej 3.49 milion Euro) mbesin të njëjtat sikurse në vlerësimin fillestar.

ZRRE rithekson që mekanizmi balancues nuk ka identifikuar pjesë të energjisë e cila kërkohet të korrigjohet nga FSHU ashtu siç është paraqitur në kalkulimet e sajë, rrjedhimisht kostot e palëve përgjegjëse për jobalancet e shkaktuara kanë mbetur të njëjta bazuar në faturimet dhe korrigjimet e bëra nga KOSTT. Duke marrë parasysh sqarimet e dhëna, kostot e jobalanceve për FSHU mbesin 3.49 milion Euro dhe jo 4.2 milion Euro ashtu siç është kërkuar nga FSHU.

Bazuar në shpjegimet e dhëna më sipër, faktori korrigjues i të hyrave për vitin 2020 rezulton të jetë 6.79 milion Euro. Ky korrigjim bartet në kalkulimin e të hyrave për vitin relevant tarifor 2021.

## 6 Borxhi i keq

FSHU thekson se gjatë llogaritjes së nivelit të borxheve të këqija aktuale nuk duhet marrë në konsideratë të gjitha të hyrat e Furnizuesit. Po ashtu pretendon se raporti aktual i borxheve të këqija është më i lartë, duke shprehur gjithashtu shqetësimin se i njëjti nivel do të rritet edhe më tej kur marrim parasysh daljen e konsumatorëve të kyçur në nivelin 35 kV dhe 10 kV në tregun e parregulluar, meqë FSHU do të mbetet kryesisht me pagesit jo të rregullt, të cilët priren të vonojnë dhe/ose të refuzojë pagesat e tyre të faturave të pranuar. Gjithashtu FSHU pretendon se përhapja e pandemisë gjatë vitit 2020 kishte një efekt negativ në normën e arkëtimit nga faturat e energjisë elektrike. FSHU në kalkulimet e bëra ka aplikuar nivelin e borxhit të keq prej 5%.

### *Përgjigjet e ZRRE-së*

ZRRE në përcaktimin e të Hyrave për KESCO lejon një nivel të arsyeshëm të borxhit të keq përmes vendosjes së parametrave kyç rregulltar gjatë shqyrtimit periodik. Niveli i borxhit të keq përcaktohet duke u bazuar në të dhënat historike dhe pritshmërinë për përmirësim të performancës. Gjithashtu, një faktor i rëndësishëm gjatë përcaktimit të nivelit të borxhit të keq, është edhe krahasimi me operatorët tjerë në vendet e rajonit dhe vende tjera me karakteristika të ngjashme rregullative dhe ekonomike. Prandaj, ZRRE inkurajon operatorin që të bëjë përpjekje për të ruajtur nivelin e borxhit të keq brenda nivelit të lejuar.

Përkundër shqetësimeve të KESCO për derregullimin e çmimeve dhe ndikimit të tij në rritjen e borxhit të keq, ZRRE konsideron që pretendimet e KESCO nuk janë të arsyeshme në këtë kohë. Në shqyrtimet e ardhshme të parametrave, ZRRE ndër tjera do të rishqyrtoj edhe rrethanat e reja të krijuara pas derregullimit. ZRRE konsideron që niveli i lejuar i borxhit të keq prej 4% është i arsyeshëm edhe këtë vit relevant tarifor dhe do të aplikohet i njëjti deri në vendosjen e parametrave hyrës për FSHU.



## 7 Të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU për vitin relevant tarifor 2021

Pas vlerësimit të të gjitha të dhënave në dispozicion dhe atyre të paraqitura nga palët e interesit gjatë konsultimit publik, propozimi përfundimtar i ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU) për vitin relevant tarifor 2021 është paraqitur në tabelën e mëposhtme. ZRRE do ta trajtojë ndryshimin në mes të vlerësimit të saj për të Hyrat e Lejuara të nevojshme për FSHU dhe të Hyrave që FSHU pritet t'i mbledhë nga tarifat e tanishme si masë balancuese, që mund të përdoret në shqyrtimet e tarifave të energjisë elektrike në të ardhmen.

ZRRE vlerëson se ndryshimi në mes të të Hyrave të Lejuara të vlerësuara nga ZRRE-ja dhe të Hyrave që pritet të mbulohen nga tarifat e rregulluara në fuqi është rreth 5.0 milion euro. Ky ndryshim do të alokohet në Llogarinë Balancuese të Tarifave (LBT). Bilanci i kësaj llogarie do të përshtatet në proceset e ardhshme tarifore.

### MAR i propozuar për vitin relevant tarifor 2021

MAR-i i Furnizuesit me Shërbim Universal	Njësia	Propozimi fillestar 2021	Propozimi i FSHU-së 2021	Propozimi përfundimtar 2021
<b>Parametrat e indeksimit</b>				
Norma e interesit It	%	6.85%	6.85%	6.85%
<b>Kostot me pakice te furnizuesit</b>				
OPEX - $OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	4.6	6.0	4.6
Zhvlerësimi - $DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	0.1	0.1	0.1
<b>Kostot e bartshme</b>				
Kostot e OST	€m	14.3	21.5	17.8
Kostot e OSSh	€m	81.4	104.2	90.5
Kostot për fondin e BRE	€m	14.8	11.9	9.9
<b>Kapitali punues (WCLC<sub>t</sub>)</b>				
$WCLC = (1 / 12) * It * (RETR_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFRT_t)$	€m	1.4	1.7	1.5
<b>Kostot për blerjen e energjisë</b>				
Kostot e blerjes së energjisë me shumicë	€m	137.1	149.4	147.2
<b>Taksa për licencë</b>				
Taksa për licencë	€m	0.02	0.0	0.03
<b>Borxhi i keq (BDTA)</b>				
BDTA	%	4%	5%	4%
BDTA	€m	10.8	15.8	11.6
<b>Përshtatjet e të hyrave për FSHU</b>				
Përshtatjet e vitit 2020	€m	6.5	5.5	6.8
<b>Të hyrat e lejuara maksimale</b>	<b>€m</b>	<b>271.2</b>	<b>316.2</b>	<b>290.1</b>

Duhet pasur parasysh se rritja e kostove jo domosdoshmërisht nënkupton edhe rritje të tarifave, ngase në vitin 2021 ka edhe rritje të konsumit, respektivisht priten të hyra më të larta nga faturimi.

Më poshtë në mënyrë grafike është paraqitur pjesëmarrja e kostove sipas aktiviteteve në kostot e përgjithshme për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve të rregulluar.




Figura 1 - Pjesëmarrja e kostove sipas aktiviteteve

Shenim: Fondi për Burimet e Ripërtërithme të Energjisë (BRE) është fondi i krijuar dhe menaxhuar nga operatori i tregut në përputhje me rregullën për skemën mbështetëse.